

AKSION HUMANITAR “MËRGATA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuar, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit.

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare që punon në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale. Misioni i Handikos është të ndihmojë dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke u siguruar atyre një mjedis të përshtatshëm, ndihmë profesionale dhe ndërveprim social. Kjo shoqatë është përkushtuar të bëjë ndryshime pozitive në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe të promovojë ndërgjegjësimin dhe tolerancën në shoqëri për të siguruar një shoqëri më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Shërbimet për fëmijë të cilat ofrohen në qendrën e Handikos Ferizaj janë:

- Seanca profesionale/terapia e punës (individuale, grupore, terapia e lojës, terapia e artit, terapia e dramës);
- Këshillime dhe mbështetje psikologjike për fëmijë dhe adoleshentë;
- Organizimi i takimeve të grupeve vetë-ndihmëse për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Aktivitete argëtuese të cilat provojnë përfshirjen sociale dhe pavarësinë e tyre;
- Plani Portige;
- Fizioterapia;
- Edukim joformal.

Shërbimet për të rritur që ofrohen në qendrën e Handikos Ferizaj janë:

- Mbështetje psikologjike/këshillimi;
- Mbështetje/këshillim infermieri;
- Mbështetje sociale;
- Seancat këshilluese për anëtarët e familjes dhe këshillimi grupor;
- Aktivitete kreative;
- Aktivitete sociale dhe rekreative.

Aktivitet grupore janë:

- Grupi i kineziterapisë;
- Grupi i tregimit të ngjarjeve/kujtimeve;
- Grupi i gatimit;
- Grupi i shikimit të filmave.

Që nga viti 2020 Handikos Ferizaj po përballet me mungesë të hapësirave fizike për të përmbushur nevojat e plota të komunitetit të saj, pasi që në bazë të të dhënave që posedon janë të regjistruar **1008** anëtarë dy gjinitë të gjitha moshave dhe ka një hapësirë prej **120m²** që as minimalisht nuk i plotëson nevojat për aktivitetet dhe shërbimet që zhvillojmë ne si organizatë.

Nisur nga kjo gjendje faktike, disa nga bashkatdhetarët tanë në mërgim morën iniciativën për përkrahjen e tyre në ndërtimin e një objekti të ri.

Kjo iniciativë ka rrjedhë spontanisht pas një takimi me z. Bujar Neziri, dhe më vonë kësaj iniciative ju bashkuan edhe z. Shabi Reka dhe z. Rustem Kashtanjeva. Megjithatë, kësaj nisme i'u bashkuan edhe shumë bashkatdhetarë tjerë.

Pas disa takimeve, u formua këshilli nismëtar prej **17 anëtarëve bashkatdhetarë (shih listën e anëtarëve në fund të dokumentit)**, të cilët do të shtrijnë aktivite në gjithë Evropën si dhe në SHBA.

Nr	Emri Mbiemri	Nr Telefonit	E-mail
1	Shabi Reka	+491772729016	//
2	Bujar Neziri	+491788888073	//
3	Xhemshir Zenuni	+41797783012	//
4	Rrustem Kashtanjeva	+491714880575	info@kashtanjeva.de
5	Burim Reka	+32486963862	//
6	Përparim Reka	+32486081628	//
7	Uran Reka	+447949621374	//
8	Bajram Begisholli	+491737628887	bajramebegisholli.de
9	Halil Kashtanjeva	+491762359109	//
10	Naim Konjufca	+1726173666	//
11	Ali Kamberi	+491738566676	//
12	Rrahman Veseli	+491718955840	//
13	Sylejman Jakupi	+491735114940	//
14	Mejdi Sejdiu	+41762134285	//
15	Naim Neziri	+41767790511	//
16	Besim Neziri	+4917849887515	//
17	Musli Zeqiri	+4915174210061	//
Përfaqësues nga Handikos Ferizaj.			
1	Enver Kasumi	+38344278689	eenver.kasumi@gmail.com
2	Nexhat Hasani	+38349500994	//
Përfaqësues Vendor.			
1	Bahri Shefkiju	+38344318225	bp.struktura@gmail.com
2	Zekrija Kamberi	+38349124904	
3	Blerim Rexhepi	+38344325067	Bleruri_07@hotmail.com

Gjithashtu, gjatë këtij rrugëtimi kemi premtime për mbështetje nga institucionet Lokale dhe Qendrore.

Dëshirojmë t'i ftojme të gjithë ata të cilët mund të kontribuojnë në çfarëdo forme, që të jenë pjesë e kësaj nisme të madhe për të ndërtuar një objekt të ri.

Sipas parallogarive tona, pritët që projekti të kushtojë rreth **400,000.00€** (Katërqindmijë Euro).

Lista fillestare e kontributdhënësve

Nr	Emri Mbiemri	Shuma
1	Bujar Neziri	10,000.00€
2	Burim dhe Përparim Reka	10,000.00€
3	Xhemshir Zenuni	4,000.00 CHF
4	Sylë Jakupi	3,000.00€
5	Bajram Begisholli	3,000.00€
6	Ali Kamberi	3,000.00€
7	Firma "NAKA BAU" (Vëllezërit Naim, Halil dhe Fanol Kashtanjeva)	2,500.00€
8	Uran Rekaj	2,000.00€
9	Zekerja Kamberi	2,000.00€
10	Rrustem Kashatanjeva	2,000.00€
11	Arjan Kashatnjeva	500.00€
12	Edison Kashtanjeva	500.00€
13	Shabi Rekaj	300.00€
14	Burim Rashiti	200.00€
15	Bahri Shefkiju gratis projektin kryesor me vlerë prej	5,000.00€
	Totali	48,000.00€


[Takimi ku u zgjodh këshilli koordinues i bashkatdhetarëve](#)



Në emër të Handikos Ferizaj, dhe në emër të personave me aftësi të kufizuara, ju falënderojmë për zemërgjerësinë dhe dëshirën tuaj për të sjellë ndryshime të vërteta në jetët e tyre. Ju jeni dëshmi e një angazhimi të vërtetë ndaj përmirësimit të shoqërisë sonë dhe krijimit të një mjedisi të barabartë për të gjithë.

AKTIVITETET QË ZHVILLOHEN NË HANDIKOS DHE QË DËSHMOJNË MUNGESËN E HAPËSIRAVE TË MJAFTUESHME PËR PUNËN QË BËJMË.

SHËRBIMET FIZIO-TERAPEUTIKE ME TË CILËT PO PUNOHET KRYESISHT NË MOTORIKËN FINE DHE GROSË



SHËRBIMET E EDUKIMIT JOFORMAL



SHËRBIMET PSIKOLOGJIKE



SHËRBIMET PSIKO SOCIALE



SHËRBIMET LOGOPEDIKE



AKTIVITETE GRUPORE



OFRIMI I SHËRBIMEVE ME BAZË NË SHTËPI

